



Prishtinë, 07.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1430_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2224_09_21** i dt.06.09.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **23.09.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **07.10.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.M nga Komuna e Mitrovicës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2224_09_21, i datës 06.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 06.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2224_09_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit A.M dhe e ka obliguar ndërmarrjen KESCO që t'i anulojë të gjitha faturat me njehsorin elektrik nr. 44170476 dhe se obligohet KESCO që për periudhën kontestuese të faturohet me shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 53895536, të periudhës 01/2020 deri me 09/2020.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO konsideron se faturimi për periudhën 01/2019 deri më 09/2019 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsorin elektrik nr. 44170476.
- ZRrE vendimin e saj e arsyeton në krahasimin e shpenzimeve për periudhën e njëjtë me njehsorin paraprak dhe me njehsorin pas periudhës kontestuese, por si i tillë nuk është fakt i vetëm dhe real se njehsori ka bërë matje të saktë ose jo.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2224_09_21 i datës 06.09.2021 për konsumatorin A.M.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi kontestuar është i saktë, Bordi i ZRrE-së thekson se, duke u bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listave të leximit, është konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Kurse për periudhat kontestuese, leximi është bërë nga distanca është që njehsori është njehsor i mençur (Smart Meter). Duke u bazuar në analizën e Rrjedhës së Energjisë Elektrike, për periudhën para kontestit dhe pas kontestit, Bordi ka gjetur se, konsumatori ka ndryshim të shpenzimeve, përkatësisht ka rritje të shpenzimit me njehsorin kontestues, e në veçanti në periudhën 08/2019.

Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 63895536 për periudhën 01/2018 deri në periudhën 09/2018 është **505 kWh/muaj**, kurse me njehsorin elektrik kontestues nr. 44170476 periudha 01/2019 deri në periudhën 09/2019 është **865 kWh/muaj** si dhe me njehsorin nr.53854462 për periudha 01/2020 deri në periudhën 09/2020 është **591 kWh/muaj**.

Po ashtu, sipas Procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0830509 i dt. 06.09.2019, nga punëtorët e autorizuar të KEDS është evidentuar se: *“Njehsori elektrik nuk bën matje të saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike”*, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar se, faturimi për periudhën 01/2019 deri me 09/2019 nuk ka qenë i saktë, për faktin se, siç edhe mund të shihet nga analiza e rrjedhës së energjisë elektrike, konsumatori ka shpenzim të përafërt para dhe pas periudhës kontestuese, pra shpenzimi është konstant, ndërkaq, në periudhën kontestuese – 01/2019 e deri me 09/2019 shpenzimi është më i rritur. E po ashtu, edhe në procesverbalin e KEDS është konstatuar se, njehsori elektrik nuk bën matje të saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike si dhe transaksioneve vërtetohet se fatura 1119102248DMI-9026083 datë 26.11.2019 e cila me herët ka figuruar në transaksione është korrigjuar por që e njëjta nuk figuron si korrigjim në transaksione, nuk figurojnë kWh e faturuar në CCP, nuk është njoftuar konsumatori e që kjo është në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1, 2, dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji thuhet se: *1.Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2.Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3.Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit A.M, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.